

# Ndërtesa e Rikonstruktuar e Bankës së Shqipërisë

## Fakte dhe shifra

### Ndërtesa dhe arkitektura e saj

#### 1. Ndërtesa ekzistuese

- Inaugurimi në 30 tetor 1938.
- Arkitekti projektues Vittorio Ballio Morpurgo.
- Stili arkitektonik i përket rrymës së “Racionalizmit”, e cila lulëzoi në gjysmën e parë të shekullit XIX në Evropë.
- Ndërtesa është e orientuar në një vendosje urbanistike arkitektonike të veçantë; ajo qëndron si ishull, në formë të pavarur nga ndërtesat e vendosura në shesh dhe rreth tij.
- Karakterizohet nga volume të mëdha dhe linja të forta në fasadë.
- E ndërtuar në dy krahë, verior dhe lindor.
- Anët e jashtme të fasadës të ndërtesës janë me tulla të thjeshta dekorative, të kuqërremta.
- Elementet arkitektonikë të fasadave dhe të interierëve, si dhe elementët e dritareve, dyerve dhe dekoracioneve në vetvete janë të thjeshta, por qëndrojnë në unitet të plotë në linjën e përgjithshme të ndërtesës.
- Në 70 vjet, ndërtesa pati vetëm mirëmbajtje të thjeshta.
- Ndërtesa me amortizimin në vite nuk plotësonte kërkesat minimale të infrastrukturës dhe teknologjisë të një banke qendrore moderne.

Vittorio Ballio Morpurgo: Arkitekt i njohur italian i viteve 1930-1940. Dekan i Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin “La Sapienza”, Romë. Në vitin 1938 kryen ristrukturimin e sheshit Augusto Imperatore, projekti i parë i arkitekturës moderne në qendrën historike të Romës. Ai ka projektuar muzeun e Anijeve Romake të Nemit, Pallatet e Guvernatorit, Piazza Aracoeli, etj. Në Shqipëri, ai projekttoi ndërtesat e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në Durrës, Korçë etj., por ndërtesa e Bankës së Shqipërisë në Tiranë e konceptuar si selia qendrore e Bankës vlerësohet të jetë vepra e tij më e arrirë, e cila shpreh profesionalizmin e arkitektit.

#### 2. Ndërtesa e rikonstruktuar

- Inaugurimi në 30 tetor 2015.
- Arkitekti projektues Marco Petreschi.
- Projekti i arkitekt Petreschit u përzgjedh në vitin 2008 nëpërmjet një konkursi ndërkombëtar të organizuar nga Banka e Shqipërisë.
- Gjithë përpjekjet e mëparshme të Bankës së Shqipërisë për projekte rikonstruksioni nuk kanë rezultuar të suksesshme, por përbëjnë një vlerë të shtuar dhe eksperiencë të vlefshme për hartimin e detyrës së projektimit.
- Projekti i ri përfshin rikonstruksionin e ndërtesës ekzistuese dhe konceptimin e një ndërtimi shtesë, por që në përfundim sjell një kompozim të ndërtesës si një e tërë.
- U shfrytëzua ideja e Morpurgos për ta lënë godinën të paprekur, shtesa bëhet në pjesën e pasme të ndërtesës.

- Kompozimi i ndërtesës shtesë shtrihet në dy krahët e tjerë, në atë jugor dhe perëndimor.
- Shtesa përfshin ndërtimin e 4 kateve nën tokë dhe 4 kate mbi tokë, me lartësi të njëjtë me ndërtesën ekzistuese.
- Ndërtimi nëntokë u realizua me një proces të veçantë teknik (ankorim i murit rrethues) duke qenë se gërmohej në thellësi pranë themeleve të ndërtesës ekzistuese.
- Teknologjia e ankorimit të murit rrethues nëntokësor nga pikëpamja inxhinierike përbën pjesën më delikate dhe të rëndësishme në zbatimin e projektit.
- Parimet e rikonstruksionit për ndërtesën e vjetër:
  - Ruajtje e vlerave: respektimi i vlerave arkitektonike të ndërtesës ekzistuese
  - kthim në identitet: eliminim i çdo shtese apo ndërhyrjeje të bërë në projektin origjinal të Morpurgos
  - rikonstruksion: rifreskim, restaurim dhe atje ku ka qenë e pamundur zëvendësim i elementëve arkitekturorë, duke iu përmbajtur modelit origjinal
- Tashmë, aspektet strukturore, mekanike, teknike janë përditësuar me teknologjitë më të fundit të fushës.

Marco Petreschi: u lind në Romë më 30 korrik 1944. Ai është arkitekt, mban titullin profesor dhe është Shef i Katedrës së Arkitekturës në Universitetin “La Sapienza” të Romës. Arkitekt Petreschi, përveç krijimtarisë së tij arkitektoare, është edhe një njohës i thellë i kulturës dhe traditës së arkitekturës italiane të epokës së racionalizmit, kur është realizuar projekti i Morpurgos. Projektet e tij karakterizohen nga kërkimi i vazhdueshëm i harmonisë dhe ekuilibrit mes të vjetrës dhe të resë. Ai ka realizuar disa projekte të rëndësishme si Teatri i ri Bashkiak dhe Muzeu i Arkeologjisë në Pomezia, kompleksin fetar të Apostullit Shën Thoma në Romë, Bankën e Shqipërisë etj.

### **3. Dialogu midis ekzistueses dhe të resë**

- Përdorimi i materialeve të njëjta me ato të ndërtesës së vjetër, siç janë guri i Tranit dhe tulla e kuqërremtë.
- Dy ndërtesat lidhen me njëra – tjetrën nëpërmjet një atriumi të brendshëm, që vendos përballë ngrohtësinë e tullës me ftohtësinë e mermerit të bardhë, mbushur me ajër dhe dritë.
- Ato qëndrojnë ballë për ballë e dialogojnë të bashkuara nga një mbulesë e lehtë çeliku dhe kristali (kupola e xhamtë)
- Atriumi krijon një shesh të vogël e të mbrojtur urban, frymëzuar nga tiparet historike më të vjetra të qytetit të Tiranës, si rrugicat e ngushta të mbuluara me tenda.

## Hyrjet e ndërtesës

### 1. Hyrja 1938

- Korpusi kryesor është në formën e një harku.
- Hyrja kryesore realizohet nga një portik madhështor, i cili përfshin lartësinë e fasadës dhe mbështetet në kolona të forta zbukuruar me relieve murale në argjil të pjekur në ngjyrën karakteristike të saj.
- Karakteristikë e hyrjes së bankës është bashkëjetesa e gurit me qeramikën. Guri prezanton soliditetin e thesarit që ajo ruan, kurse qeramika finesën e veprimitarisë bankare.
- Zbukuruar me stola prej guri në hyrjen kryesore.
- Lartësia e hyrjes 11 metra.
- Hyrja simbolizon dinamizmin e përparimit dhe të pasurisë që e priste kombin shqiptar.
- Në relievet e ulëta të hyrjes kryesore janë gdhendur figura të çmuara, vepra të skulptorit italian Alfredo Biagini, të cilat simbolizojnë burimet e jetës e të pasurisë së kombit.
- Në parahyrjen gjysmërrethore shfaqet portiku i lartë 6 metra, i dekoruar me mermer të zi.
- Holli i brendshëm rrethor stoliset nga mozaiku i artistit italian Giulio Rosso, me fabulën e thjeshtë “jetë-punë-paqe”, përmbi “thesarin dhe paratë”. Mozaiku zbret nga lart dhe vesh dyshemenë e hollit.
- Veshja dhe dekorimi i mureve dhe dyshemesë është i stilit antik venecian.
- Ndriçimi i hollit natyral si dhe nga një sistem ndriçimi elektrik
- Ventilim natyral i ajrit.
- Lartësia hollit të brendshëm 8 metra.
- Kjo hyrje tashmë është me karakter ceremonial, për aktivitete të rëndësishme të veçantë.

### 2. Hyrja 2015

- Hyrje këndore monumentale në krahun perëndimor, frymëzuar nga natyra shqiptare (malet, shkëmbinjte, ujëvarat, etj.).
- Hyrja ndërthur elementë modernë dekorimi siç janë qelqi, mermeri dhe uji.
- Hyrja të sjell në mendje kanionet shqiptare dhe është zbukuruar me një element artistik modern në të gjithë lartësinë e ndërtesës, veshur me gur Trani.
- Elementi dekorativ zbret drejt tokës me një shatërvan uji.
- Hyrja është konceptuar me një miniambient në të majtë të fasadës me relief të thyer me basene ujore në lartësi të ndryshme, të cilat natyrshëm krijojnë stola e vende relaksi për qytetarët.
- Basenet ujore dhe shatërvanët janë të veshur me gur Trani, zbukuruar edhe me ndriçim dekorativ.
- Lartësia e hyrjes 15 m.
- Hyrja të çon në hollin e ri kryesor zbukuruar me një shandan të prodhuar nga firma artizanale e qelqit me famë botërore, Murano.
- Shandani është prodhuar në vitin 2014. Ai përbëhet nga një pllakë e madhe rrethore nga e cila varen pllakëza të vogla qelqi me ndriçim, që i japin atij formën e një pjergulle.

- Në brendësi të hollit, në të djathtë, vazhdojnë basenet ujore, mbi të cilat lartësohen shkallët e xhamta që përshkojnë ndërtesën e re në të gjithë lartësinë e saj, mbështetur në një mur të zbukuruar me gur Trani të papërpunuar, me ngjyrë të kuqërremtë.
- Holli të nxjerr në atriumin e brendshëm të krijuar midis dy godinave, ku përballë shtrihet Muzeu i Bankës së Shqipërisë.
- Kjo hyrje është me karakter operativ dhe funksional, për personelin dhe vizitorët.
- Ajo është e pajisur me akses elektronik (kartë) si dhe me sisteme kontrolli të sigurisë së lartë (detektor metalesh, sistem kamerash sigurie, etj.).

### **3. Hyrjet të vendosura në një aks**

- Të dyja hyrjet janë të vendosura në një aks transversal, që përshkojnë mes përmes dhomën e thesarit (rotondën), tashmë pjesë e Muzeut të Bankës së Shqipërisë.

## **Muzeu i Bankës së Shqipërisë**

Studiot që realizuan projektin – Studio Rebus sh.p.k., Arkipost Engineering, Museum Engineering, Goppion.

- Sipërfaqja ~ 900 m<sup>2</sup>, i shtrirë në 2 kate të ndërtesës.
- Kati numizmatik – prezanton koleksionet numizmatike të Bankës së Shqipërisë, që nga lashtësia deri në ditët tona. Të ekspozuara në vitrina: Lingota e Artë; rreth 1500 monedha; 300 kartëmonedha dhe 200 objekte muzeore.
- Dhoma e Thesarit - e hapur për herë të parë për publikun në 2015. Gjatë viteve 1938-2010, kjo dhomë ka ruajtur brenda saj pjesë të Thesarit të Shtetit: lingota ari të standardizuar, monedha të arta e të argjendta, gurë dhe stoli të çmuara.
- Holli i bankës qendrore – në hollin historik ofrohet informacion historik mbi krijimin dhe rrugëtimin e bankës qendrore në Shqipëri (rolin e bankës qendrore). Me rastin e inaugurimit të Muzeut është çelur ekspozita e përkohshme “Thesaret etnografike të Bankës së Shqipërisë”.
- Dhoma e Hologramës - shfaq për vizitorin një rrëfenjë monedhash antike, të projektuar në hapësirë, në 3 dimensione, në 360 gradë.
- Salla e Konferencave – hapësirë për prezantime mbi bankën qendrore dhe mbi çështje me interes mbi sistemin bankar e atë financiar, nëpërmjet projektimit të filmave edukativë.
- Dhoma e Evropës - prezanton publikun me rolin, funksionet dhe rrugëtimin historik që kanë përshkruar Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Eurozona, vendosja e marrëdhënieve Shqipëri-BE, si dhe me koncepte të tjera të lidhura me procesin e integritimit evropian.
- Dhoma e Fëmijëve - hapësirë shumëfunktionale, ku vizitorët e vegjël mund të lexojnë e të luajnë individualisht me aplikacionin interaktiv “Derrkuci Çufo mëson të kursejë”, të provojnë njohuritë e tyre në kuizin “Torta e Çufos”, të punojnë e të argëtohen me fletët e shumta të punës ose të marrin pjesë të organizuar në grup në një nga aktivitetet tona.
- Dhoma e Studentëve - ambient edukativ me informacione dedikuar të rinjve dhe jo vetëm.

- Dhoma e Shitjes – ambienti ku koleksionistët, por edhe të interesuarit e fushës numizmatike mund të blejnë monedha apo kartëmonedha.

## Ambientet e brendshme

- **Zyrat në ndërtesën ekzistuese**
  - Mobilimi i brendshëm sipas projektit të Morpurgos me mobiljet origjinale të restauruara.
  - Restaurim i plotë i dyerve (janë ruajtur dyert origjinale).
  - Restaurim i gjithë mobiljeve të vjetra (proces ky i nisur që në vitin 2004).
  - Restaurim i parketeve origjinale prej druri lisi.
  - Rinovim i plotë i dritareve, duke ruajtur modelin origjinal të tyre.
- **Zyrat në ndërtesën e re**
  - **Fleksibilitet:** mundësojnë adaptimin e ndryshimeve pa ndërhyrje, nëpërmjet:
    - Parketit teknologjik që lejon shtimin/shtrirjen e rrjetit kabllor
    - Mobilim që ofron fleksibilitet në konceptimin e brendshëm të zyrave (mobilje me module).
  - **Komunikim:** ambientet e zyrave motivojnë komunikimin e hapur dhe punën në grup
  - **Transparencë:** muret e brendshëm që shikojnë nga korridori janë prej xhami.
  - Mobilimi i brendshëm ngjyrë e bardhë, me dekoracion ngjyrë lisi.
  - Mobiljet janë prej druri, të veshura me laminat të bardhë.
  - Karrige ergonomike.
- **Ambientet e tjera specifike**
  - Salla e konferencave me rreth 140 vende (në katin hyrës në të majtë).
  - Salla takimesh të pozicionuara në vende të ndryshme të godinës.
  - Restorant me rreth 80 vende për punonjësit (në katin hyrës në të djathtë).
  - Mobilimi i sallave në një linjë, mbizotëron ngjyra e bardhë.

## Parkimi

- Parkimi për automjetet e punonjësve në katet nëntokësore.
- 90 vende parkimi për automjete si dhe vend për parkimin e biçikletave dhe motorëve.
- Ventilim natyral i ajrit.
- Shfrytëzim ambienti nëpërmjet një rampe spirale zbritëse për në parkim përreth deponitës së ujit.
- Lëvizja e automjeteve për në parkimin nëntokësor në përputhje me lëvizjen urbane të qytetit.
- Hyrja në parkim ndihmohet nga një rrugë sekondare me gjerësi 3.5 m për të mos rënduar fluksin e qarkullimit të automjeteve të qytetit.
- Kontroll i lartë sigurie përpara hyrjes në parkimin nëntokësor.
- Sistem automatik i shuarjes së zjarrit.

- Mbyllje automatike e hyrjeve të kateve për shmangien e përhapjes së zjarrit (kur zjarri është në një kat).
- Sistem i mbledhjes së gazrave përgjatë rampës zbritëse në parkim.

## **Ambienti rrethues**

Dizenjimi dhe projektimi i ambientit rrethues në përputhje me parimet e Morpurgos: të vendosë në pah vlerat e ndërtesës me anë të trajtimit të duhur estetik të elementëve funksionalë arkitektonikë, duke krijuar me objektin një njësi të vetme të harmonizuar.

Sipërfaqja e përgjithshme e ambientit rrethues 1182 m<sup>2</sup>.

- Ofron hapësirë publike që siguron lëvizjen e lirë të kalimtarit dhe hyrje-dalje të mbrojtura.
- Lëvizja këmbësore sipas studimit urbanistik të realizuar nga Bashkia.
- Ndhmon hyrjen dhe daljen e lirë të automjeteve nga parkimi nëntokësor i Bankës, pa krijuar probleme për trafikun e qytetit.
- Krijon kushtet optimale për mirëmbajtjen dhe shërbimin e rrjetit inxhinierik të jashtëm të ndërtesës, si dhe të lidhjeve me infrastrukturën inxhinierike të qytetit.
- Ofron vende parkimi për vizitorët e jashtëm të Bankës gjatë organizimit të aktiviteteve të Bankës së Shqipërisë.
- Krijon një impakt pozitiv mjedisor në mbrojtjen e ambientit nga pluhuri dhe temperaturat e larta nëpërmjet gjelbërimit dhe ujit.
- Gjelbërim mesdhetar, selvi me lartësi të ulët dhe dafinë (pjesa e gjelbëruar nga Banka).
- zgjedhja e pllakave të trotuarit: gur nga Gjirokastra me tre ngjyra: gri, e kuqe dhe e bardhë.
- pllaka të veçanta për orientimin e të verbërve.

## **Për personat me aftësi të kufizuar**

- Një nga hyrjet me akses elektronik (me kartë) është më e gjerë se të tjerat për të lejuar hyrjen e personave me karroca.
- Ashensorët janë përzgjedhur për të mundësuar hyrjen e personave me aftësi të kufizuar (karroca e invalidit)
- Muzeu është konceptuar si një vend i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuar (janë instaluar edhe pajisje specifike për ngjitjen e personave me aftësi të kufizuar në ambientet e katit të dytë të Muzeut).
- Ambiente hidrosanitare specifike të vendosura në pjesë të ndryshme të godinës.

## **Koncepti i energjisë, ajrimit, ujit**

- Ventilim natyral i kombinuar me ventilim artificial, për të realizuar ventilim të shëndetshëm.
- Ventilimi i zyrave me ajër natyral nga fasada apo atriumi i brendshëm.
- Sistem i qendëruar kondicionimi, me fleksibilitet përdorimi në çdo zyrë.
- Atriumi dhe hapësirat ndërlidhëse midis dy ndërtesave janë prej xhami që mundësojnë maksimalisht dritën.

- Izolim i cilësisë së lartë gjeotermik.
- Sistem i përqendruar i mbledhjes së ujërave në katin e fundit nëntokësor.
- Pastrim i gjithë ujërave përpara daljes së tyre nga godina.
- Mbrojtje eficiente nga dielli në fasadën e xhamit (përdorimi i xhamave pasqyrë).
- Përdorim eficient i dritës (sensorë për dritën për ndriçimin e jashtëm dhe të brendshëm).

## **Në mbrojtje të shëndetit të punonjësve**

- Pajisjet e restorantit janë zgjedhur me specifika në mbrojtje të shëndetit.
- Purifikim i ujit përpara hyrjes në godinë (kundër mikrobeve, kundër kalcifikimit, etj.).
- Sinjalistikë e veçantë kundër përdorimit të duhanit në ambientet e brendshme.

## **Në mbrojtje të mjedisit**

- Gjatë rikonstruksionit, godina u vesh e gjitha me mbulesë.
- Gjatë rikonstruksionit, transporti i dherave dhe mbetjeve të gërmimeve është bërë natën.
- Gjatë rikonstruksionit, shembja e objekteve dhe gërmimet janë bërë kryesisht natën.

## **Fazat e projektit të rikonstruksionit të ndërtesës**

- Banka e Shqipërisë nuk kishte arritur të realizonte me sukses asnjë nga përpjekjet e saj përpara vitit 2008 për realizimin e projektit të rikonstruksionit të ndërtesës së saj.
- Detyra e projektimit përfundoi në vitin 2007, duke përmbledhur gjithë eksperiencat e tentativave të mëparshme për rikonstruksion. Ajo shërbeu si bazë për platformën e konkursit që u zhvillua më pas.
- Në 2007, Banka e Shqipërisë publikoi njoftimin për zhvillimin e konkursit ndërkombëtar për përzgjedhjen e projektidesë më të mirë në gazetën prestigjioze "Financial Times", në shtypin vendas dhe në faqen e saj të internetit.
- Shfaqën interes për të marrë pjesë në konkurs 27 studio projektimi dhe projektues të huaj, nga të cilët 17 prej tyre paraqitën dokumentacionin përkatës.
- Konkursi u zhvillua në tre faza në periudhën 2007-2008:
  1. Faza e parë: Kualifikimi ligjor i dokumentacionit të detyrueshëm për paraqitje nga konkurrentët, ku nga 17 konkurrentë të regjistruar u kualifikuan 8.

2. Faza e dytë: vlerësimi teknik për 8 konkurrentët e kualifikuar në fazën e parë, të cilët u mbajtën me identitet të fshehtë. Në përfundim të kësaj faze, u përzgjedhën 3 projektidetë më të mira.
  3. Faza e tretë: vlerësimi final duke renditur me pikë 3 projektidetë, ku në përfundim të kësaj faze projekti i paraqitur nga studio Petreschi mori pikët më të larta.
- Juria përbëhej nga 11 anëtarë: Guvernatori dhe përfaqësues të lartë të Bankës së Shqipërisë, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Kulturës, Bashkisë së Tiranës, Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë, si dhe përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës së Italisë.
  - Punimet kryesore strukturore nisën në vitin 2011 dhe përfunduan në vitin 2014.
  - Gjatë vitit 2015 u punua kryesisht për rregullimin e ambientit rrethues.

## **Shifra dhe fakte 2015**

- Punimet kryesore strukturore nisën në vitin 2011 dhe përfunduan në vitin 2014, ndërsa në vitin 2015 u punua kryesisht për rregullimin e ambientit rrethues.
- Punimet u kryen nga firma Acmar në bashkëpunim me CAE (bashkim i operatorëve ekonomikë), fituese në përfundim të tenderit përkatës.
- Alokimi i punonjësve në ndërtesën e rikonstruktuar u bë në dhjetor 2014.
- Aktualisht janë të akomoduar rreth 200 punonjës të Bankës së Shqipërisë.
- Ambientet nëntokësore përdoren vetëm për parkimin, shërbimet ndihmëse dhe infrastrukturën teknologjike.
- Sipërfaqja e ndërtimit 3000 m<sup>2</sup>.
- Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës së vjetër 4000 m<sup>2</sup>.
- Sipërfaqja e përgjithshme aktuale 14.000 m<sup>2</sup>.
- Sipërfaqja e Muzeut ~900 m<sup>2</sup>.
- Vëllimi i përgjithshëm 57.000 m<sup>3</sup>.
- Sipërfaqja e ambientit rrethues 1182m<sup>2</sup>.